



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 411 Akti

Nr. 515 Vendimi
Tiranë, më 3.3.2022.

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Firdes Shuli	Kryesuese
Suela Zhegu	Relatore
Brunilda Bekteshi	Anëtare

asistuar gjatë procesit të vendimmarrjes nga sekretarja gjyqësore, znj. Etmonda Hoxha, në prani të vëzhguesit ndërkombëtar znj. Marie Tuma, në datën 3.3.2022, mori në shqyrtim, mbi bazë dokumentesh, çështjen që i përket subjektit të rivlerësimit:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Z. Sokol Tona**, gjyqtar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

BAZA LIGJORE: **Neni 179/b** i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë;
Neni G i Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë;
Ligji nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;
Ligji nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;
Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;
Vendimi nr. 78, datë 12.12.2017, i Gjykatës Kushtetuese.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi relatoren e çështjes, shqyrtoi dhe analizoi dokumentacionin dhe çështjen në tërësi, bazuar në vlerësimin tërësor të procedurave sipas pikës 2, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016,

V Ë R E N:

1. Subjekti i rivlerësimit Sokol Tona, gjatë periudhës së rivlerësimit, ka ushtruar detyrën e gjyqtarit në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë. Në zbatim të pikës 3, të nenit 179/b, të Kushtetutës si dhe të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim ligji nr. 84/2016), ky subjekt i është nënshtruar procesit të rivlerësimit *ex officio*.
2. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, më 16.12.2019, në përputhje me rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit”, zhvilloi procedurat e shpërndarjes së çështjeve me short, nga i cili rezultoi se subjekti i rivlerësimit Sokol Tona, do t’i nënshtrohej procesit të rivlerësimit nga trupi gjykues i përbërë nga komisionerët: Firdes Shuli, Brunilda Bektoshi dhe Suela Zhegu. Relator i çështjes me short u zgjodh komisionere Suela Zhegu.
3. Menjëherë pas hedhjes së shortit, bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, u administruan raportet e hartuara nga institucionet: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (ILDKPKI); Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK) dhe Këshilli i Lartë Gjyqësor (KLGJ).
4. Trupi gjykues i shortuar në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit (në vijim Komisioni), me vendimin e datës 23.12.2019, vendosi fillimin e hetimit administrativ të thelluar dhe të gjithanshëm sipas nenit 45 të ligjit nr. 84/2016, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, si dhe të caktojë kryesues të trupit gjykues komisioneren Firdes Shuli. Të gjithë anëtarët deklaruan mosqenien në kushtet e konfliktit të interesit.
5. Në zbatim të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, nga subjekti i rivlerësimit janë nisur procedurat e rivlerësimit, si vijojnë: (a) plotësimi dhe dërgimi i deklaratës së pasurisë, sipas shtojcës 2 të ligjit nr. 84/2016, pranë ILDKPKI-së, brenda 30 ditëve nga data e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 84/2016, sipas nenit 31; (b) plotësimi dhe dërgimi i deklaratës për kontrollin e figurës, sipas shtojcës 3 të ligjit nr. 84/2016, pranë DSIK-së, brenda 30 ditëve nga data e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 84/2016, sipas nenit 35; (c) plotësimi dhe dërgimi i formularit të vetëvlerësimit profesional, sipas shtojcës 4, të ligjit nr. 84/2016, pranë organit të vlerësimit të aftësive profesionale, brenda 30 ditëve nga data e hyrjes në fuqi, sipas nenit 41 të ligjit nr. 84/2016.
6. Në datën 13.1.2020 subjekti i rivlerësimit u njoftua nëpërmjet postës elektronike mbi fillimin e procesit të rivlerësimit kalimtar, si dhe mbi përbërjen e trupit gjykues, për të cilën deklaroi se nuk kishte konflikt interesi me asnjë nga anëtarët e tij.
7. Në datën 3.11.2021, subjekti i rivlerësimit Sokol Tona njoftoi Komisionin se do të paraqesë kërkesë për miratimin e pensionit të parakohshëm dhe ndërprerjen e statusit të gjyqtarit, kërkesë e cila është dërguar në KLGJ, në datën 12.11.2021.

8. Në datën 14.2.2022, në Komision është regjistruar vendimi nr. **, datë 8.2.2022, i KLGJ-së¹, i cili mbështetur në pikat 1 e 1/2, të nenit 27 dhe në germën “c”, të pikës 1, të nenit 64, të ligjit nr. 96/2016, ka vendosur: “(1) pranimin e kërkesës; (2) miratimin e pensionit të parakohshëm për magjistratin z. Sokol Tona; (3) pensioni i parakohshëm për magjistratin Sokol Tona llogaritet dhe paguhet nga organet e sigurimeve shoqërore sipas përcaktimeve të nenit 27, pika 1/2, të ligjit nr. 96/2016; (4) mbarimin e statusit të magjistratit Sokol Tona, gjyqtar i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, për shkak të daljes në pension të parakohshëm pleqërie; (5) efektet juridike të urdhërimeve sipas pikave 3 dhe 4 të këtij vendimi fillojnë në datën 28.2.2022; (6) përjashtimin e menjëhershëm të gjyqtarit Sokol Tona nga procedura e ndarjes së çështjeve gjyqësore në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë; (7) një kopje e vendimit i njoftohet magjistratit, gjyqtarit Sokol Tona, Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe Institutit të Sigurimeve Shoqërore; (8) kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të tij; (9) ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor”.

Ky vendim i është përcjellë subjektit të rivlerësimit dhe Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

9. Në mbështetje të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, në datën 15.2.2022, subjekti Sokol Tona u njoftua mbi të drejtën që gëzon për t’u dëgjuar në seancën dëgjimore dhe nëse do të ushtronte të drejtën e ankimit ndaj vendimit nr. **, datë 8.2.2022, të KLGJ-së.

10. Subjekti i rivlerësimit, me anë të postës elektronike me e-mail datë 15.2.2022, ka konfirmuar se vendimi nr. **, datë 8.2.2022, i KLGJ-së është shprehje e miratimit të vullnetit të tij dhe kërkesës për përfitimin e pensionit të parakohshëm të pleqërisë dhe, për rrjedhojë, nuk do të ankimojë vendimin e KLGJ-së, si dhe ka njoftuar Komisionin se nuk dëshiron të ushtrtojë të drejtën për t’u dëgjuar në seancë dëgjimore. Gjithashtu, Gjykata Administrative e Apelit Tiranë, ka informuar se deri më datë 2.3.2022, nga z. Tona nuk është depozituar ankim ndaj vendimit me nr. **, datë 8.2.2022 të KLGJ-së.

I. ARSYET PËR PËRFUNDIMIN E PROCESIT TË RIVLERËSIMIT

11. Procesi i rivlerësimit që kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit është një proces kushtetues, që mbështetet në nenin 179/b të Aneksit të Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

12. Trupi gjykues konstaton se z. Sokol Tona, me detyrë gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, i nënshtrohet procesit të rivlerësimit *ex officio*, referuar përkufizimit të termit “magjistrat” në germën “gj”, të nenit 2, të ligjit nr. 96/2016.

13. Në germën “b”, të pikës 1, të nenit 164, të ligjit nr. 96/2016, parashikohet se statusin e magjistratit, të parashikuar në këtë ligj, e gëzojnë gjyqtarët dhe prokurorët në detyrë, por ky status do të mbahet vetëm nëse kalohet me sukses procesi i rivlerësimit dhe konfirmohen në detyrë.

14. Rastet e mbarimit të statusit të magjistratit janë përcaktuar në pikën 1, të nenit 64, të ligjit nr. 96/2016 kur: (a) jep dorëheqjen; (b) vërtetohen kushtet e pazgjedhshmërisë dhe të

¹Shkresë nr. *** prot., datë 10.2.2022, të KLGJ-së, regjistruar në Komision me nr. ** prot., datë 14.2.2022.

papajtueshmërisë në ushtrimin e funksionit; (c) mbush moshën e pensionit të pleqërisë, sipas parashikimit të këtij ligji; (ç) shkarkohet nga funksioni për përgjegjësi disiplinore, sipas parashikimeve të këtij ligji; (d) vërtetohet fakti i pamundësisë për të ushtruar detyrën.

15. Në rastin konkret, subjekti i rivlerësimit Sokol Tona ka shprehur vullnetin për të mos vijuar ushtrimin e detyrës, pavarësisht se ende nuk ka mbushur moshën 67 vjeç, kohë kur mbarimi i statusit për shkak të moshës deklarohet nga KLGJ-ja.

16. Shprehja e vullnetit të subjektit për të ndërprerë marrëdhëniet e tij të punës, bërja prezent para Komisionit e këtij fakti dhe formalizimi me paraqitjen e kërkesës drejtuar KLGJ-së, çmohen nga trupi gjykues si ndërprerje për shkak të vullnetit të subjektit për të lënë detyrën përpara kohe, duke e konsideruar këtë si dorëheqje të tij.

17. Për sa më sipër, në kushtet kur subjekti i rivlerësimit me veprime konkrete ka hequr dorë nga ushtrimi i detyrës së gjyqtarit, ndërkohë që ende nuk ka mbushur moshën 67 vjeç, të përcaktuar nga ligji nr. 96/2016, trupi gjykues vlerëson se për sa subjekti i rivlerësimit me vullnetin e tij ka lënë detyrën që ushtronte përkundrejt mundësisë ligjore për të vazhduar ushtrimin e funksionit, situata faktike kualifikohet sipas parashikimeve të germës “a”, të pikës 1, të nenit 64, të ligjit nr. 96/2016, dorëheqje nga detyra.

18. Mbarimi i statusit të magjistratit, parashikuar nga germa “a”, e pikës 1, të nenit 64 dhe nenit 65 të ligjit nr. 96/2016, nuk lidhet vetëm me ndalimin e ushtrimit efektivisht të detyrës në kuptim të ligjit nr. 96/2016, por në të njëjtën kohë dhe në mënyrë të pashmangshme edhe me procesin e rivlerësimit në zbatim të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, duke sjellë për pasojë edhe humbjen e statusit si subjekt rivlerësimi *ex officio* dhe ndërprerjen e procesit të rivlerësimit.

19. Dispozitat kushtetuese dhe ligjore, si dhe vendimet e Gjykatës Kushtetuese në lidhje me procesin e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve, parashikojnë ndërprerjen e procesit të rivlerësimit për shkak të dorëheqjes, duke zbatuar në këtë rast nenin G të Aneksit të Kushtetutës, që parashikon ndalimin e subjektit të rivlerësimit për t’u emëruar gjyqtar ose prokuror i çdo niveli, anëtar i KLGJ-së ose i KLP-së, Inspektor i Lartë i Drejtësisë ose Prokuror i Përgjithshëm, për një periudhë 15-vjeçare.

20. Trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk pengohet nga e drejta e tij për të aplikuar dhe përfituar pension pleqërie, siç edhe faktikisht ka ndodhur, por në kuadër të parashikimeve të ligjit nr. 96/2016, prej të cilit subjekti i rivlerësimit ka gëzuar statusin e magjistratit dhe përfitimet e tjera që rrjedhin prej tij, subjekti ka fituar edhe të drejtën për të qëndruar në detyrë deri në mbushjen e moshës 67-vjeçare dhe detyrimin për t’iu nënshtruar edhe procesit të rivlerësimit.

21. Refuzimi i subjektit të rivlerësimit për të vijuar ushtrimin e detyrës së gjyqtarit deri në moshën 67 vjeç, konsiderohet dorëheqje nga detyra e gjyqtarit/statusi i magjistratit në kuptim të germës “a”, të pikës 1, të nenit 64, të ligjit nr. 96/2016, që sjell si pasojë ndërprerjen e procesit të rivlerësimit dhe zbatimin e ndalimit të parashikuar në nenin G të Aneksit të Kushtetutës.

22. Ndërprerja e procesit të rivlerësimit, për shkak të dorëheqjes së subjektit të rivlerësimit, sjell si pasojë përfundimin e kësaj procedure administrative dhe, si rrjedhojë, subjekti i rivlerësimit humbet të drejtën për t’u emëruar gjyqtar ose prokuror i çdo niveli, anëtar i KLGJ-

së ose i KLP-së, Inspektor i Lartë i Drejtësisë ose Prokuror i Përgjithshëm, për një periudhë 15-vjeçare, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit G, të Aneksit të Kushtetutës.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, mbështetur në nenin G të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenit 57 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe në nenet 64 dhe 65 të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

V E N D O S I:

1. Të deklarojë ndërprerjen e procesit të rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit Sokol Tona.
 2. Ndalimin e emërimit të z. Sokol Tona si gjyqtar ose prokuror i çdo niveli, anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor ose Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektor i Lartë i Drejtësisë ose Prokuror i Përgjithshëm, për një periudhë 15-vjeçare.
 3. Ky vendim i njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë, si dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.
 4. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Kolegjin e Posaçëm të Apelit brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të tij dhe duhet të dorëzohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.
- U shpall në Tiranë, më 3.3.2022.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Firdes SHULI
Kryesuese

Suela ZHEGU
Relatore

Brunilda BEKTESHI
Anëtare

Sekretare gjyqësore
Etmonda Hoxha